



№. 40 prot
Shkodër 20/06/18

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 6 Datë 13.06.2018

**PËR MOSMIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI
ELEKTRIKE SUBJEKTIT “Albania Tourist Resort” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr. 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika 1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim(miratim ne parim) të subjektit “Albania Tourist Resort” SH.P.K, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V E N D O S I :

1-Mosmiratimin në parim të kërkesës së subjektit “Albania Tourist Resort” SH.P.K me administrator Znj. Ana SHTJEFNI, për përdorim të burimit ujor **Përroi i Mizës**, degë e Lumit të Thethit për prodhim energjie elektrike në fshatin Nderlyasaj, Njësia Administrative Shalë, Bashkia Shkodër, Qarku Shkodër .

2- Kjo kërkesë nuk është miratuar për arsyet e mëposhtme:

-Ndikon negativisht në monumentin natyror “Syri i kalter”.

-Shkatërron faunën ujore (speciet e kërcënuara janë me statuse të ndryshme në listën e kuqe të florës dhe faunës)

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Çesk MILLJA

